



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

## Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok

Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa / Komitet za Politiku i Financije / Policy and Finance Committee

9

### Proces verbal

Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	22.11.2018, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare për punë të Kuvendit të Komunes
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Haki Podrimaj, Besa Ferati, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardita Idrizaj, Ajshe Metaj.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjera:	Nënkyretari Agim Ademaj, Hysni Maxharraj, Hatixhe Arifaj, Edona Bujupi Loxha, Besart Dreshaj, Mujë Osmanaj, Hazbi Bajra, Zekie Sutaj, Jeta Balaj, Hysen Pelaj OSBE,

### Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluar,
2. Pyetje nga anëtaret e Komitetit për Politikë e Financa,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.

### Diskutimet:

Kryesuesi – z. Qaush Balaj - përshëndet Nënkyretarin z. Agim Ademaj, anëtaret e Komitetit për Politikë e Financa, Drejtoret, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, KFORI, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje.

Duke pasur parasysh se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes se Komitetit për Politikë e Financa.

Ne rend dite kemi një gabim teknik pika e dytë duhet të hiqet.

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje.

Hedhe në votim rendin e ditës.

**Konstatojmë se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje.**

### Vendimet:

**Miratohet unanim rendi i ditës nga KPF-së pa vërejtje****Personat përgjegjës për zbatim:****Afati për zbatim:****Shqyrtimi i pikës 1.****Diskutimet:**

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyete nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rrëth procesverbalit.

Pasi që nuk partë diskutime

Procesverbalii hidhet në miratim:

**Vendimet:****Miratohet Prosesverbalii nga mbledhja e kaluar pa vërejtje,****Personat përgjegjës për zbatim:****Afati për zbatim:****Shqyrtimi i pikës 2.****Diskutimet:**

Kryesuesi - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019.

Nënkyetari i Komunës z. Agim Ademaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, iu uron punë të mbar dhe fjale ja kalon Hysni Maxharraj.

Hyseni Maxharraj – Drejtor për Buxhet dhe Financa, përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019.

Lulzim Shoshi - Drejtor i Bujqësis, përshëndet të gjithë të pranishmit, kamë një pyetje nga fermerët të cilët e punojnë token, pyesin se a ka ulje të tarifës për fermerët të cilët punojnë token.

Hyseni Maxharraj – Drejtor për Buxhet dhe Financa, tokat që punohen nuk do të paguaj tatim, janë të liruara nga tatim pagimi.

Ajshe Metaj, PDK – e kemi analizuar rregulloren, ju drejtor thatë që keni caktu njësit me të vogla për tarifa, si ndikon kjo në buxhet? Dhe a keni të drejt ta bëni ketë.

Hyseni Maxharraj – Drejtor për Buxhet dhe Financa, e kemi propozuar ne tarifën me të vogël e jo caktuar se ne nuk mund të caktojm tarifa dhe ju në Kuvend vendosni .

Haki Podrimaj, LDK – në bazë të cilit ligj dhe udhëzim nuk paguhen tokat e punueshme, p.sh unë kam të mbjellur një pronë me grurë ndërsa doktori e ka livadh të dyat janë toka të punueshme por a lirohen te dyat nga pagesa s'po si qëndron puna këtu.

Hatixhe Arifaj, Udhëheqës e sektorit për tatim në pronë – tatimi në pronë te jenë me lirë tarifat nuk ka shancë për me u liru, për toka që punohen nuk do të paguhet tatim me ligjin mbi tatimin në pronë, për livadhe nuk ka lirime, pemishtet e ndryshme, vreshtat kanë lirime, nëse një fermer nuk është përfitues i subvencioneve ne e kemi dërguar një shkres në Ministrin e Financave me pyet se a mund të lirohet nga tatime për aq pronë sa punon, dhe po presim përgjigen.

Haki Podrimaj, LDK – kjo nuk po me pëlqen dhe do të kemi probleme me këto. Shtëpitë tatimohen por a do të tatimohet oborri përreth shtëpisë.

Hatixhe Arifaj, Udhëheqës e sektorit për tatim në pronë – po do të tatimohet edhe oborri dhe parcela rezidenciale .

Zenel Shatri, LDK – po me intereson toka e punuar dhe ajo e pa punuar, si do të paguan prej sa ari do të paguhen tokat e punueshme.

Eliot Kukiqi, AAK – sa është e caktuar sa hektar tok të punshme duhet me i pas 3 hektar, 2 apo 5 ose të caktohet sa.

Hatixhe Arifaj, Udhëheqës e sektorit për tatim në pronë – në takimin që kemi qenë për këto tarifa është mbetur që Ministria e Bujqësisë të merret me këto probleme. Por nëse shfrytëzuesi i parcelës nuk është titullari i parcelës por titullari është tjetër për pagesën do të obligohet personi që e shfrytëzon pronën.

Ajshe Metaj, PDK – pagesa pronës ne banesat shumëkatëshe si do të bëhet?

Hatixhe Arifaj, Udhëheqës e sektorit për tatim në pronë – objektet afariste do të paguajnë secili banorë në mënyre të barabartë.

Hazbi Bajra, Shef i kabinetit të Kryetarit – a do të jetë kjo rregullore për çdo vite me u miratua si ajo me herët apo do të mbetet kjo për disa vite?

Hyseni Maxharraj – Drejtor për Buxhet dhe Financa – po do të jetë si rregullorja e mëparshme për çdo vit do të ndryshohet.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime të tjera, KPF-ja vendosi:** që Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019 i kalohet Kuvendorit për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendorit

**Afatit për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendorit

**Shqyrtimi i pikës 3.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.

Prezanton dhe sqaron Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.

Eliot Kukiqi, AAK – propozon që në plan të punës të hy një mbledhje solemne për ndër të ditës së shlirimit të Istogut.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2019 dhe propozimin e Eliot Kukiqit, miratohet një zëri.

#### Vendimet:

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019, dhe e njëjtë i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

#### DISKUTIME

Ajshe Metaj, PDK – ku jeni me procedurat e lloaptopve apo sdo të kemi llooptopa fare.

Edona Bujupi Loxha – Drejtoresh e Administrates, përshendet të gjith të pranishmit, përfituesi është shpallur dhe llooptopat do të janë brenda këtij muaji.

Kryesuesi – para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezentë ishin të gjithë anëtar e Komitetit për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje.

Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoj :**

11:10